



01Nr. 104/02-17698/23

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit 04/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 8.7, të Rregullores 06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, si dhe rekomandimit të komisionit përzgjedhës, Kryetari i Komunës me datë 03.08.2023 merr këtë :

**VENDIM
PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE**

I. Me këtë vendim iu ndahen subvencione përfitueseve në bazë të thirrjes publike në programin "Gratë në Biznes" sipas listës të rekomanduar nga Komisioni për ndarjen e subvencioneve në DZHET.

II. Përfitueset si në pikën I të këtij vendimi janë:

1. Arianita Dullovi B.I;
2. Blerina Fera (DD Acount SH.P.K);
3. Drita Dervishi B.I (D.P.Z Sallon Ondulimi "Dy Yjet");
4. Kosovare Krasniqi B.I (Pastrimi Jeta);
5. Lavdije Rrushi B.I (N.T.P "Taste");
6. Nurhane Raka B.I (N.T.P "Ajana");
7. Shkurte Dema B.I (Linda Dekor);
8. Vlora Idrizi Kriva B.I (P.P.Z "Vlora").

III. Shuma totale e mjeteve financiare për subvencionim të përfitueseve është 15,154.50 €.

IV. Pagesat për përfitueset do të kryhen nga Kodi Ekonomik - Subvencione dhe Transfere - nënprogrami 48028, Planifikimi i Zhvillimit Ekonomik.

Arsyetim

Më datë 21.07.2023, Komisioni për ndarjen e subvencioneve në DZHET ka bërë Rekomandim 01Nr. 104/02-17698/23 për ndarjen e subvencioneve për 8 (tetë) kandidatet fituese dhe ka refuzuar 3 (tre) aplikacione. Pas përfundimit të afatit të ankesave, marrëveshjet individuale do të lidhen konform dispozitave ligjore neni 13 , Rregullorja Nr .06/2016. Kryetari i Komunës duke u bazuar në këtë rekomandim si dhe në kompetencat ligjore , vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

V. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen : Kryetari i Komunës, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Kryetari i Komunës
z.Besim Ilazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01- Nr. 600/01-17613/2023
Kaçanik, 08.08.2023

Bazuar në Ligjin nr.03/L-40- Për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin Nr.08/L-193 Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, Marrëveshjes për Bashkëfinancimin e Projektit "Avancimi i perbashket i trajnimeve dhe punesimit ne sektorin e Arsimit ne Kosovë" Nr.01-104/02-5564 të dt.23.03.2023, si dhe të nenit 61.dhe 73, të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

**PËR NDARJEN E MJETEVE BUXHETORE PËR BASHKFINACIM TË PROJEKTIT
"Avancimi i perbashket i trajnimeve dhe punesimit ne sektorin e Arsimit ne Kosovë"**

1. Me këtë vendim lejohen mjetet finaciare nga Buxheti i Komunës së Kaçanikut për vitin 2023 në shumë prej **410.70 €** për participimin e Komunës për projektin *Avancimi i perbashket i trajnimeve dhe punesimit ne sektorin e Arsimit ne Kosovë*", sipas marrëveshjes së bashkëfinancimit të arritur në mes të Komunës dhe Organizates "Caritas Switzerland (në Kosovë).

2. Mjete buxhetore nga pika 1.e këtij vendimit ,do të sigurohen nga nën-programi buxhetor 16028 Zyra e Kryetarit, përkatësisht nga kategoria ekonomike e Mallrave dhe Sherbimeve.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

4. Me këtë Vendim njoftohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arkivi i Komunës.

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi